

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	MUHAMED HALILI: Ju rrëfej “aferën e armëve” me Shqipërinë. Si Berisha shkatërroi PPD-në përmes skemave të shërbimit maqedonas
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/10/muhamed-halili-ju-rrrefej-aferen-e-armeve-me-shqiperine-si-berisha-shkaterroi-ppd-ne-permes-skemave-te-sherbimit-maqedonas/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 06:48:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	9 shtator 2026, 22:00:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 9 shtator 2026, 21:59:00 UTC → 9 shtator 2026, 22:01:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	96bcc19b253847c644ee3d1a20e3abff5a2ae982b285f5b49d68e742cf9130c3
TEKSTI	02733b7777c1a5f6228e967a122c08f818404c5de77798c94bcd6c95eec4274b
PAMJA	1675c390f473a4891d849ada73a90e404ba9bf1d49304f2cdf5d03c335e8045f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e232c9f8bfd0d81de1ae5656ccf85bf3b7456dc6fef46ecf7fac092c35877d8e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3cbdf23231ddbe1301737130b50cb215bb8d138f7bee92a7c7c6c6c8c9c45afe
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te bllok, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e232c9f8bfd0d81de1ae5656ccf85bf3b7456dc6fef46ecf7fac092c35877d8e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

MUHAJED HALILI: Ju rrëfej “aferën e armëve” me Shqipërinë. Si Berisha shkatërroi PPD-në përmes skemave të shërbimit maqedonas

Memorie

Publikuar: 10/09/2026

f X



Nga Muhamed Halili

Sipas rrëfimit të Muhamed Halilit, “afera e armëve” nisi nga frika e drejtuesve të PPD-së se shpërbërja e Jugosllavisë dhe luftërat në Slloveni e Kroaci mund të përhapeshin edhe në Maqedoni. Në këtë klimë, në shtator 1991, drejtuesit e PPD-së vendosën të krijonin një rrjet të fshehtë vetëmbrojtjeje në vendbanimet shqiptare, me argumentin se duhej të ishin të përgatitur për një ndërhyrje të mundshme të JNA-së. Nevzat Halili mori fillimisht drejtimin e organizimit, por drejtuesit e tjerë të PPD-së e detyruan të tërhiqej nga funksioni ushtarak, nga frika se përfshirja e drejtpërdrejtë e kryetarit të partisë mund të sillte ndalimin e PPD-së. Drejtimin më pas, sipas dëshmisë, e mori sekretari i përgjithshëm Mithat Emini.

Halili e vendos këtë organizim në një mjedis ku, sipas tij, edhe qarqe maqedonase po armatosehin për t’u mbrojtur nga JNA-ja. Ai pretendon madje se ekzistonte një mirëkuptim joformal ndërmjet njerëzve të PPD-së dhe qarqeve të VMRO-DPMNE-së për nevojën e formacioneve të tilla. Problemi, sipas rrëfimit, ishte se pas krijimit të ushtrisë së Maqedonisë strukturat shqiptare nuk u shpërbënë plotësisht. Në maj 1993, ministri i Jashtëm maqedonas Stevo Červenkovski ia paraqiti çështjen ministrit shqiptar Alfred Serreqi si provë të ndërhyrjes së Shqipërisë në Maqedoni, ndërsa në nëntor 1993 policia maqedonase goditi strukturën e quajtur nga hetuesit “Batalioni 777”, duke arrestuar

Me të lexuarat

Kush është

Behajdin Allaqi, njeriu që Haga vendosi në qendër të dënimit të



Doktor Mëu përdori bash te Rruga e Kosovareve dhe biznes shit-bleje pronash, deri pas hapsh të video



pornografike në një bisedë me shoqet, si u zbulua abuzimi i 12-vjeçares



Historia e gjeneralit kroat të Bosnjes që vrau veten me helm në sallën e gjykimit në



Haga nën de... me naftë/ Shehu kërkon llogari për gjenocidin serb, Haga rikthen akuzat e ...



Seiam Elmazin, Mysen Haskajn, Snenasi Rexnepin, Burim Murtezanin, Refet Elmazin dhe të tjerë.

Pjesa politikisht më e fortë e dëshmisë është ajo që vjen pas arrestimeve. PPD-ja kërkoi lirin dhe më pas abolimin e të arrestuarve dhe kërcënoi edhe me largimin nga qeveria. Pikërisht në këtë moment shfaqet përplasja me Tiranën. Sipas Halilit, ambasadori i sapoemëruar Shaban Murati u kërkoi deputetëve të PPD-së të distancoheshin nga organizimi, duke e interpretuar atë si një operacion të lidhur me Millosheviqin për destabilizimin e Maqedonisë dhe diskreditimin e Shqipërisë e të shqiptarëve. Halili, përkundrazi, këmbëngul se organizimi kishte lindur si strukturë vetëmbrojtjeje kundër një agresioni të mundshëm të JNA-së.

Arbër Xhaferi dhe Menduh Thaci të mbështetur nga PD në Tiranë. Vizitat e emisarëve të PD në Tetovë për të ndihmuar XHaferin. Montimi I aferës së armëve dhe ndërhyrja brutale e Tiranës zyrtare që shkatërroi gjithcka. Ibrahim Rugova qëndroi larg përcarjes dhe tentoi të mbroj vijën zyrtare të PPD

Rrëfimi autentik

Në ditët që Maqedonia feston 35-vjetorin e pavarësimit të saj, është e frytshme të përkujtojmë edhe ngjarjet e rrugëtimit të vendit drejt pavarësimit, si dhe sfidat me të cilat u ndesh lëvizja e parë politike në vend, si dhe ambiciet që ushqenin në atë kohë liderë shqiptarë (Berisha dhe Nano) për ta promovuar veten si “mbrojtës” të interesave mbarëkombëtare shqiptare, gjë që solli dobësimin e forcës politike të shqiptarëve në përgjithësi në vendet ku ata vepronin politikisht, me theks të posaçëm në Kosovë (Nano-Millosheviq në Kretë) dhe Maqedoni (PD dhe Berisha).

Një veprim që në vitin 1991 e mori kryesia e Partisë për Prosperitet Demokratik për organizimin e njëjësive vetëmbrojtëse në vendbanimet shqiptare në Maqedoni, fill para shkatërrimit të Jugosllavisë dhe nisjes së agresionit serb në Slloveni dhe Kroaci, e pagëzuar si “Afera e armëve” nga ana e policisë maqedonase, la pasoja të rënda në funksionimin e lëvizjes politike shqiptare në Maqedoni, si dhe në tërë organizimin politik shqiptar pas kësaj kohe.





Një veprimtari përgatitëse për t'iu kundërvënë aksionit të mundshëm ushtarak të forcave të JNA-së në Maqedoni (kryekomandant i së cilave ishte gjakatari Millosheviq), posaçërisht në vendbanimet shqiptare, mbaroi me burgosjen e pjesëtarëve të forcave paraushtarake shqiptare dhe dorëheqjen kolektive të kryesisë së PPD-së, që vazhdoi më pas me situata të turbullta në skenën politike shqiptare për një kohë të gjatë në Maqedoni, duke vazhduar deri në ditët e sotme.

Edhe pse kishte kaluar një kohë e gjatë e ekzistimit të këtyre forcave, këto veprime të forcave paraushtarake shqiptare establishmenti politik maqedonas i bëri publike më 25 maj 1993, në vigjilje të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, në Romë, ku ministri i Jashtëm maqedonas Stevo Crvenkovski, në praninë e ministrit të Jashtëm turk Ismail Çetin, me një grumbull dokumentacioni të incizuar të aktiviteteve të këtyre forcave, e akuzoi ministrin e Jashtëm shqiptar Alfred Serreqi se Shqipëria po e destabilizon Maqedoninë.

Natyrisht se ky veprim pati efekte pozitive në politikën e jashtme të Maqedonisë, sepse pas këtyre ngjarjeve u bë pranimi i vendit në OSBE, që PPD-ja e kundërshtonte pa plotësimin e kërkesave shqiptare, njohja e pavarësisë së vendit nga ana e Shqipërisë, gjë që e dëmtoi tepër rëndë lëvizjen tonë politike.

Barra e gjithë këtyre aktiviteteve ra në shpinën e PPD-së, e cila këtë e pagoi me zhdukjen e saj nga skena politike në vend.

Për fat të keq të shqiptarëve në Maqedoni, shkatërrimi i PPD-së sot e kësaj dite solli trauma të papara në organizimin politik të shqiptarëve në Maqedoni dhe, si pasojë e kësaj, vendin e PPD-së nuk e zunë forca të idealit kombëtar dhe dijes politike, por forca që synuan dhe synojnë që politikën ta shndërrojnë në burim të pashtershëm të pasurimit vetjak, në përkrahës të krimit dhe korrupsionit.

Fillimet e shpërbërjes së Jugosllavisë: agresioni serb ndaj Sllovenisë dhe Kroacisë

Në fillim të vitit 1991, ushtria jugosllave JNA udhëhiqej dhe ishte nën ndikimin e eprorëve ushtarakë serbë dhe filloi mobilizimin e forcave ushtarake në Maqedoni për të luftuar kundër pavarësisë së Sllovenisë dhe Kroacisë.

Më 6 maj 1991, në kazermën e Splitit, gjatë një proteste të 30 mijë qytetarëve kundër keqpërdorimit të JNA-së në luftën kundër pavarësisë së Kroacisë, u vra ushtari nga Kavadari Sashko

Me të marrë lajmin, udhëheqja e PPD-së të nesërmen thirri një kuvend qendror në fshatin Pirok të Tetovës dhe vendosi që aktivistë të saj të bënin aktivitete derë më derë dhe t'u jepnin instruksione të rinjve shqiptarë t'i iknin mobilizimit për ushtrinë jugosllave. Maqedonasit filluan të mobilizoheshin dhe armatoseshin gati legalisht me arsenalin që e kishte mbrojtja territoriale dhe armë që flitej se vinin nga jashtë.

Kështu, në defilim në Manastir u paraqit aradha e Cërnomarovit, një ish-kryeshef në njësinë rajonale të Punëve të Brendshme në Manastir, ndërsa një deputet nacionalist maqedonas dhe nënkryetar i VMRO-DPMNE-së, Vladimir Gollubovski, deklaroi se kishte në dispozicion rreth 20 mijë të rinj që do të luftonin në raste të posaçme kundër JNA-së së Kadijeviqit.

Nisur nga përvoja e keqe e konfliktit serbo-kroat, ne i frikësoheshim mundësisë edhe të prishjes së marrëdhënieve jo të mira ndëretnike dhe marrjes së një kahjeje jo të pëlqyeshme të një konflikti të mundshëm ndëretnik në Maqedoni.

Në portalin "Civil", duke rrëfyer për projektin "E kaluara, e tashmja dhe e ardhmja e kontrollit të armatimit në Maqedoninë e Veriut", më 12 janar 2022, profesori universitar dhe eksperti për siguri, Prof. dr. Ivan Babanovski, deklaroi: "Askush nuk e di se ku mbaroi armatimi që Arkan ia dha (Jordan) Mijalkovit. Ndoshta mbaroi në Pelister, nën kontrollin e Cërnomarovit", ka deklaruar ai.

E dyta, rreth kësaj teme, në një emision në YouTube, i intervistuar nga gazetari Ivanov, profesori Babanovski deklaroi se "më 6 nëntor 1991 në Shkup erdhi Zhelko Razhnatović-Arkan (udhëheqës i formacionit paraushtarak 'Garda vullnetare serbe') dhe solli dy kamionë me armë. Ai ishte mysafir i ministrit të Brendshëm Jordan Mijalkov, unë atë kohë isha këshilltar i tij", deklaroi profesori. "Atë periudhë kohore nuk isha në shoqërinë e tij, por rrija me ata në hotelin Holiday Inn, hotel Grandin e atëhershëm", përfundon ai.

Pyetjes ku sot është ai armatim, pas gjithë atyre ditëve, ai i përgjigjet se Arkani e solli armatimin, ishte mysafir i Dane-s (Tanevski), drejtor i Makedonijaturistit, i cili më vonë e mori Holiday Inn-in. Profesori Babanovski vazhdon rrëfimin duke thënë se "Mijalkov, Done, Gjorgji Naumov (ministri i Drejtësisë) dhe Rade Perishiq, i cili ishte në lidhje martesore me motrën e Jellcinit (presidenti i mëparshëm rus Boris Jellcin), dhe ai bashkë me Arkani e solli armatimin këtu. Ai armatim mbaroi këtu në Pelister, nën kontrollin e Cërnomarovit, dhe deri sot për këtë askush nuk dha përgjigje çka ndodhi", rrëfen ai.

Të gjendur në një situatë të tillë ku lloj-lloj grupesh maqedonasish armatoseshin dhe të rinjtë e të gjitha republikave

Filluan të mobilizoheshin për të bërë luftë për interesa të nuaja,
ne, kryesia e ngushtë e PPD-së, ishim të bindur se ishte vështirë
t'i iknim luftës, pasi gjithë republikat e Jugosllavisë ndizeshin
flakë dhe JNA bënte kërdi në Bosnjë dhe Kroaci. Filluam të bënim
përgatitje për të gjetur burime, për ta armatosur popullatën dhe
për të krijuar fond për këtë.

Fillimet e organizimit të forcave të armatosura



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.